

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2 Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
Tiranë, Shqipëri E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900094/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Rekomandim për garantimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në Qendrën e Zhvillimit Durrës

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

ZONJËS MERITA XHAFAJ

**DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT SOCIAL
SHTETËROR**

ZONJËS LUNEDA SUFALI

DREJTORIT TË QENDRËS SË ZHVILLIMIT

ZOTIT ARLIND VATA

TIRANË

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, në mbështetje të Kushtetutës, ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, si dhetë urdhrin nr.327, datë 6.9.2018, të Avokatit të Popullit "Për inspektimin e institucioneve të përkujdesit social, rezidencial dhe ditor, që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë", realizoi në datën 17.10.2018, inspektimin në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi dhe inspektimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'Ju parashtrojë përfundimet e tij, si më poshtë vijon:

Objektivat e inspektimit:

- kontrolli i performancës në institucionet, që ofrojnë shërbime të përkujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuar, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave;
- vlerësimi i cilësisë së punës së personelit të institucioneve të përkujdesit social;
- vlerësimi i mjediseve dhe kushteve të insitucionit;
- vlerësimi social-psikologjik-shëndetësor i çdo përfituesi në institucionet e përkujdesit social;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve, në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar në fuqi.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një jurist dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

Së pari, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e këtij institucioni, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.

Së dyti, zhvillimin e intervistave me punonjësit dhe përfituesit e institucionit, për cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Së treti, monitorimin e nivelit të zbatimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi në kontekstin e respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Së katërti, monitorimin emjediseve dhe kushteve të Qendrës së Zhvillimit, ku ofrohen shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe me probleme të shëndetit mendor.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit ka zhvilluar bisedën përmyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, bazuar në konkluzionet e inspektimit të ushtruar në Qendrën e Zhvillimit Durrës në të gjithë institucionin, intervistave të zhvilluara me punonjës social, kujdestarët dhe përfituesit e shërbimeve, si dhe vëzhgimeve të kryera, për të provuar cilësinë e shërbimit që i ofrohet fëmijës, ku u adresuan problematikat e evidentuara

gjatë inspektimit, si edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuar në fund të këtij raporti.

Më lejoni, t'Ju parashtroj ndërtimin strukturor dhe profilin e Qendrës së Zhvillimit Durrës, si vijon:

Qendra e Zhvillimit Durrës

Qendra e Zhvillimit Durrës është një nga institucionet publike kombëtare, në varësi administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Kjo qendër ofron shërbime rezidenciale për fëmijë/të rinj me aftësi të kufizuar, të ardhur nga familje me probleme të vështira social-ekonomike, deri në moshën 25 vjeç, kryesisht nga qarku i Durrësit, por dhe nga rrethe të tjera të vendit. Profili i përfituesve, në numrin më të madh të tyre, i përkasin kategorisë së përfituesve të braktisur nga familja biologjike.

Kjo qendër ka një certifikatë regjistrimi me nr.NIPT.K51703526H, datë 9.2.2016, të Ministrisë së Financave.Në zbatim të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ende nuk kanë përfunduar procesin e licensimit, si rrjedhojë e problematikës së mbartur ndër vite,atë të mos lëshimit të cerifikatës së pronësisë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, Durrës¹. Nga vlerësimi i dokumentacioneve të vëna ne dispozicion nga institucioni i përkujdesit social rezidencial për fëmijët me aftësi të kufizuar, komunikimi zyrtar i kryer, ndërmjet Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme Durrës dhe Qendrës së Zhvillimit Durrës, rezulton se ZVRPP Durrës nuk ka respektuar afatet kohore të kthimit të përgjigjës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Funksionimi dhe organizimi i Qendrës së Zhvillimit Durrës realizohet në mbështetje të rregullores së brendshme nr.1569, datë 7.7.2016, miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, në mbështetje të

¹ Qendra e Zhvillimit, Durrës ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme Durrës, me numër aplikimi 20224, datë 3.4.2017, për t'u pajisur me certifikat pronësie. Nëshkresën zyrtare me nr.9027 prot. datë 12.7.2017, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme Durrës, i kërkon Qendrës së Zhvillimit Durrës plotësimin e dokumentacionit, ku është konstatuar se nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor,i arshivuar në ZVRPP krahasur me të dhënat që disponon ZVRPP, sipas VKM sipërfaqja e truallit është 2420 metra katror dhe sipërfaqja e ndërtimit është 626 metra katror ndërsa planit të rilevimit pasuria 4/35 në kartelën e pasurisë sipërfaqja e truallit është 2827 metra katror dhe sipërfaqja e ndërtimit 711.18 metra katror. Si rrjedhojë këtyre mospërputhjeve ZRPP nuk e ka pajisur qendrën me certifikatën e pronësisë, si dhe i ka kërkuar Qendrës së Zhvillimit të korigjojë planin e rivelimit, sipas domumentacioneve tekniko-ligjor të VKM, ku të përgatisin dhe planimetritë e kateve tëdy objekteve. Menjëherë, pas kësaj kërkesë, Qendra e Zhvillimit Durrës në shkresën zyrtare me nr.165 prot., datë 31.10.2017,ju ka dërguar planin e rilevimit dhe planimetritë e kateve të dy objekteve, sipas kërkesës zyrtare së ZRPP Durrës, por ende nuk ka marrë një përgjigje zyrtare, si dhe as certifikatën e pronësisë.

legjislacionit ndërkombëtar dhe atij të brendshëm për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij².

Shërbimet e ofruara në këtë institucion, sipas deklaratës së qëllimit të parashikuar në këtë dokument janë:

- mbështetje dhe ndihmë për përfituesit dhe këshillim për familjet e tyre;
- akomodim dhe ushqim;
- edukim dhe rehabilitim;
- ndërhyrje social-shëndetësore për të përfituar autonomi individuale për aktivitetet e përditëshme dhe integrim.

Nismën për dërgimin (referimin) e personave me aftësi të kufizuar në këtë institucion e ndërmarrin prindërit, kujdestari i caktuar me vendim gjykatë ose nga KMCAP-i, Policia e Shtetit, administratori shoqëror i njësisë administrative përkatëse, si dhe seksioni për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore në nivel bashkie. Ndërsa, për sa i përket vendimmarrjes për sistemimin dhe akomodimin e personave me aftësi të kufizuar në qendër, ky vendimëhtë kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Në këtë qendër kanë të drejtë të marrin shërbime personat me aftësi të kufizuar mendore, sensore dhe fizike të grupmoshës nga 0-25 vjeç.

Struktura e institucionit miratohet me urdhër të Kryeministrit dhe, në përputhje me rregulloren e institucionit, organigrama përbëhet nga 28 punonjës, të klasifikuar në pozicionet e punës, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|----------|
| - Drejtor | 1 (një); |
| - Sektori i shërbimit social | |
| përgjegjes sektori social (punonjes social) | 1 (një); |
| specialist (fizioterapist) | 1 (një); |
| specialist (ortofonist) | 1 (një); |

² i) Konveta e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”;

ii) Ligji nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;

iii) Vendimi nr.658, datë 17.10.2005, i Këshillit të Ministrave “Për standardet e shërbimeve shoqërore”;

iv) Vendimi nr.822, datë 6.12.2006, i Këshillit të Ministrave “Për standardet e përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale”;

v) Vendimi nr.425, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesit shoqëror”, të ndryshuar

vi) Udhëzimi nr.1730, datë 27.9.2010, i ministrit përgjegjës “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, përpunat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”.

specialist (edukator)	4 (katër);
kujdestar	12 (dymbëdhjetë);
- Sektori i administratës	
përgjegjes në sektorin e financës	1 (një);
kuzhinier	1 (një);
pjatatarës	1 (një);
punëtor mirëmbajtës	1 (një);
sanitar	4 (katër).

Vlerësimi sasior dhe dinamika e lëvizjes së përfituesit të qendrës

Kapaciteti i qendrës është për 45 përfitues residencialë. Aktualisht, qendra ofron shërbime të përkujdesit shoqëror për 37 përfitues rezidencialë, prej të cilëve 18 janë femra dhe 19 meshkuj. Moshë e përfituesve të qendrës varion nga 4 vjeç deri në 27 vjeç. Nga vlerësimi i diagnozës, 9 përfitues janë me paaftësi fizike dhe 39 janë me paaftësi mendore. Nga numri total i tyre, 31 përfitues marrin zhvillim dhe 9 përfitues nuk marrin zhvillim.

Nga vlerësimi dhe analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion ekipi inspektues konstatoi se, kapaciteti i përfituesve në qendër kryet nga kriteri i vlerësimit të hapësirës fizike që qendra disponon. Konkretisht, kapaciteti i përfituesve të qendrës duhet të jetë në harmonizim dhe në përputhje edhe me organigramën e strukturës së institucionit, sipas standardve të kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet e përkujdesit social rezidencial dhe ditor.

Dinamika

Kapaciteti i qendrës	45 përfitues	37 përfitues
Numri aktual i përfituesve		
Vendosur në institucion gjatë vitit 2000		1 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2005		1 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2006		1 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2008		8 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2009		2 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2010		1 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2011		5 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2012		2 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2013		3 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2014		6 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2015		3 përfitues
Vendosur në institucion gjatë vitit 2016		1 përfitues

Vendosur në institucion gjatë vitit 2018 3 përfitues

Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës të të dhënave të përfituesve, u konstatua, se janë të vendosur në qendër persona mbi moshën 25 vjeç, gjithsej 4 raste.

Diagnoza e përfituesve është si vijon:

- përfitues me prapambetje të rëndë mendore;
- përfitues me prapambetje të moderuar;
- përfitues me çrregullime të spektrit autik;
- përfitues me çrregullime të sjelljes (oligofreni, debilitet i thellë, epilepsi);
- 7 përfitues më prapambetje fizike (paralizë cerebrale, paralizë e zhvillimit psiko-motor.

Nga të dhënat e lartpërmendura, koha e qëndrimit mesatarisht në institucion është 4 vjet. Normalisht, kjo kohë qëndrimi është e lartë në vlerësim të tipologjisë së shërbimit rezidencial që ofrohet (shërbim i mbyllur). Ky tregues shpreh, se mosveprimi me apo pa dashje i personave përgjegjës, për rritjen dhe përkujdesjen, kanë penguar integritetin fizik, mendor dhe zhvillimin e përfituesve, duke i mbajtur për një periudhë kohe të gjatë të institucionalizuar e, për rrjedhojë kanë neglizhuar në mirëqenien ndaj tyre.

Nga informacioni i siguruar, nëpërmjet intervistimit të drejtuesit të këtij institucioni, 11 fëmijë frekuentojnë shkollën speciale, ndërsa vetëm një fëmijë frekuenton shkollën publike. Gjithashtu, 2 përfitues kanë mbaruar kurset e formimit profesional të certifikuar për rrobaqepsi dhe kuzhinier. Pavarësisht bashkëpunimit, që qendra ka kërkuar me Zyrat e Punës, për punësimin e tyre, ky bashkëpunim ka hasur në pengesa, pasi subjektet (punëdhënësit) kërkojnë shoqërimin e tyre nga stafi i qendrës.

Për sa më sipër, mungesa e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës, ndërmjet institucioneve jashtë qendrës, konkretisht Zyrate të Punës Durrës, Qendrës së Formimit Profesional, Durrës, kanë ndikuar në pengimin e integritetit të personave me aftësi të kufizuar. Ata me mosveprimet e tyre, me dashje apo pa dashje, nuk kanë mundur garantimin e një jetese të pavarur, duke cenuar e shkelur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar, për trajtim të barabartë, kundrejt shërbimeve publike të ofruara sipas legjislacionit në fuqi.

Për vlerësimin e nevojave të përfituesve me aftësi të kufizuar përfshihen të gjithë profesionistët, që punojë drejtpërsëdrejti me ta. Ofrimi i këtyre

shërbimeve që kryejnë, është në përputhje me procedurat e parshikuara në rregullore, të tilla si:

- procedurat e funksionimit të ekipit multidisiplinor;
- procedura e përkujdesit shëndetësor;
- procedura për arsimimin;
- procedura për zbavitjen;
- procedura e ankimimit;
- procedurat e marrjes së mendimit të fëmijëve për organizimin e jetës në shtëpi;
- procedurat e mbrojtjes nga abuzimet dhe procedurat e raportimit;
- procedurat e mbrojtjes nga zjarri dhe procedurat e emergjencës;
- procedurat e mbajtjes së lidhjeve me familjarët;
- procedurat e largimit nga qendra.

Të gjitha procedurat e sipërpërmendura janë të mbështetura ligjërisht në vendimin nr.822, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave “Për standardet e shërbimeve shoqërore, personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”, si dhe udhëzimit në zbatim të këtij vendimi, ku kujdesi në qendër mbështetet në profesionalizimin e një ekipi multidisiplinor, me qëllim maksimalizimin e potencialit të përfituesve.

Mbështetja financiare e Qendrës së Zhvillimit, Durrës

Qendra e Zhvillimit Durrës është institucion publik në varësitë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe, mbështetet nga fondet e buxhetit të shtetit.

Nga informacioni i kërkuar, fondi i parashikuar dhe realizuar ndër vite ka qenë si vijon:

- 30.603.050 lekë, për vitin 2016;
- 32.881.330 lekë, për vitin 2017 dhe,
- për vitin 2018, fondi i parashikuar ka qenë 33.445.000 lekë dhe realizimi i tij deri në tetor 2018, ishte 26.678.424 lekë.

Gjithashtu, qendra bashkëpunon edhe me shumë organizata të shoqërisë civile dhe fetare, si Kisha Ortodokse, e cila kishte pajisur institucionin me krevate prej druri, tavolina, dollape, etj. Ndërsa, Motrat Adhuresë të Gjakut Krishtit për periudhën e verës, nëpërmjet rrjetit të vullnetarëve, mundëson veprimtari të ndryshme okupacionale, si p.sh.: shoqërimi në plazh i përfituesve.

Vlerësimi i mjediseve strukturore të Qendrës së Zhvillimit, Durrës

Institucioni përbëhet nga dy godina, ku për të plotësuar nevojat minimale të përshtatshme të aftësisë së kufizuar të përfituesve, organizimi i tyre është realizuar në ndarjen e përfituesve sipas shkallës së aftësisë së tyre të kufizuar.

Në katin e dytë të njëjës prej godinave, janë vendosur përfituesit me prapambetje të rënda mendore, ku aftësia për t'u zhvilluar është më e vështirë. Tualetet janë të vendosura në fund të katit. Kohët e fundit, këto mjedise janë rikonstruktuar me arkitekturë dhe pajisje të përshtatshme me nevojat e personave me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike. Numri i personave të vendosur në dhomë, varion nga katër deri në pesë persona, ku vihej re se përfituesit PAK joautosufiçentë, janë të vendosur me persona me aftësi të kufizuar jo të rënduar, për të mundësuar ndihmesën që mund t'u jepej këtyre personave.

Ajo çka konstatohet për dhomat e gjumit, është fakti, se këto mjedise nuk janë në përputhje me standardet e vendosura sipas legjislacionit në fuqi, ku çdo dhomë duhet të ketë dy përfitues dhe sipërfaqja e tyre duhet të jetë 18 metra katror. Po kështu, në të gjitha mjediset e shërbimeve higjienike dhe në dhomat e fjetjes pranë çdo shtrati³, mungon sinjalistika për thirrje, në rastet e nevojave. Tualetet nuk janë të lidhura me mjediset e përbashkëta të socializimit.

Në godinën e dytë janë akomoduar përfitues, të cilët kanë mundësi të marrin zhvillim më shumë dhe kanë prapambetje mendore të lehta. Kjo godinë është e pajisur me ashensor për të lehtësuar lëvizjen e fëmijëve, që përdorin karrige me rrota, por madhësia e dhomave (ku numri i përfituesve varion nga 4-5 përfitues për dhomë), nuk favorizon lëvizjen dhe rrotullimin e karrocave. Gjithashtu, edhe në dhomat e gjumit të kësaj godine, pranë çdo shtrati, mungon sinjalistika për thirrje në rastet e nevojave.

Dhomat e gjumit janë të pajisura me të gjitha elementet e hotelerisë, krevate, jastëk, batanije, etj., por në vend të çarçafëve përdoren batanije të lehta e të ngrohta për përfituesit. Pavarësisht justifikimit (që përfituesit të flenë ngrohtë), vendosja e çarçafit, mundësisht të bardhë, është tregues i rëndësishëm në plotësimin e kriterëve të higjienës personale të çdo përfituesi⁴.

³Vendimi nr.822, datë 6.12.2006, i Këshillit të Ministrave, "Për standardet e përkujdesit shoqëror, personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale" dhe udhëzimi nr.1730, datë 27.9.2010 i ministrit përgjegjës për çështjet sociale "Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, përpersonat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore".

⁴ Kjo problematike e konstatuar nga ekipi i inspektimit gjatë vëzhgimit të realizuar në ambientet e qendrës ju vu në dukje në takimin përmblyës me drejtuesin e institucionit të përkujdesit social rezidencial, i cili e

Numri i përfituesve të akomoduar në dhomat e gjumit, është mbi kapacitet dhe nuk garanton një mjedis të ngrohtë familjar. Gjithashtu, njëri prej përfituesve joautosufiçentë, i vendosur në një krevat normal, i rrethuar nga dy krevate të tjerë (për të evituar rrezikun e rënies nga krevati në çdo moment), nuk plotëson nevojat e tij në përputhje edhe me standardet e përkujdesit social për personat me aftësi të kufizuar. Kur vlerësohen nevojat e përfituesve dhe hartohen planet e përkujdesit, detyrimisht, i vetmi shërbim i përshtashëm për aftësinë e tij të kufizuar, është krevati me të gjithë elementët e domosdoshëm për përshtashmërinë e tij.

Dhomat e gjumit në të dyja katet kishin dalje në mjediset e përbashkëta për socializim dhe një mjedis tjetër për të ofruar vaktet ushqimore.

Në katet e para të të dyja godinave, hapësirat janë të organizuara me mjedise të ndryshme si:

- kuzhina me të gjitha pajisjet frigoriferike të nevojshme për funksionimin normal të përgatitjes së ushqimit, pastrimin e pjatave, etj. (në katin e parë të njërës godinë);
- për socializim, për atelie, laboratorë pune, fizioterapie, klasa, etj., ku ofrohen shërbimet për kryerjen e programeve sipas disiplinave të ndryshme, të cilat cilësohen të përshtatshme dhe plotësojnë nevojat për zhvillimin e veprimtarive me përfituesit, në përputhje me kapacitetin maksimal të qendrës.

Në të dyja godinat, shkallët që lidhin katin e parë me katin e dytë kanë të vendosur parrakët e mbajtjes, e evidentuar kjo edhe në korridoret kryesore të tyre. Oborri i institucionit ishte i sistemuar në mënyrë të rregullt dhe i pajisur me kënd lojrash, është funksional dhe, shfrytëzohet në çdo kohë nga përfituesit.

Sistemi i ngrohjes kryhej me kaldajë të përgjithshme me naftë, që ndizej me orare të caktuara tre herë në ditë, si dhe me ngrohës elektrik. Lidhur me sistemin ftohës, ai kryhej me kondicionerë. Qendra siguronte ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë në çdo kohë.

Sigurimi i mjediseve është realizuar me vendosjen e katër kamerave: një në hyrje të institucionit, një në korridor dhe dy në klasat ku zhvillohet terapia. Gjithashtu, godina ruhet me shërbim të sigurisë private, 24 orë në 24.

vlerësoi me vend, dhe u angazhua për të reflektuar sa më shpjet të jetë e mundur vendosjen e çarçafëve të bardhë për cdo përfitues.

Nga vlerësimi i informacionit të sipërpërmendur, struktura e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, Durrës, është me arkitektonikë të vjetër, ku janë bërë përpjekje për të shmangur pengesat infrastrukturore, por nuk i plotëson të gjitha kërkesat dhe normat arkitektonike urbanistike, ndërtimore, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Vlerësimi i stafit që ofrojnë shërbime të drejtëpërdrejta në raport me përfituesit

Qendra e Zhvillimit Durrës sipas organigramës së mësipërme, ka një staf prej 28 punonjësish dhe një mjek part-time. Nga numri total i punonjësve, në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, janë vetëm 19 punonjës të profesioneve si vijon: një punonjës social, një ortofensit, një fizioterapist dhe katër edukatorë. Ndërkohë, numri total i përfituesve, që marrin shërbime në këtë qendër ishte 37.

Në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi, raporti i parashikuar përfitues-specialist në qendrat rezidenciale të zhvillimit, që ofrojnë shërbime të përkujdesit social për fëmijë mbi moshën 14 vjeç, duhet të jetë sipas specialiteteve si më poshtë:

- 1-10 fëmijë, një punonjës social, një psikolog apo psikiatër për adoleshentë, një fizioterapist, një ortofonist, një okupacionist, një infermier;
- 1-20 fëmijë, një neurolog apo neuropsikiatër;
- 1-5 fëmijë, një specialist edukator.

Gjithashtu, standardet ndërkombëtare sugjerojnë, se raporti i specialistëve me përfituesit duhet të jetë 1:10 dhe, në pamundësi, nevojat duhet të plotësohen me specialistë me kohë të pjesshme.

Për sa më sipër, konstatojmë, që numri i specialistëve të tillë si: psikolog, neurolog apo neuropsikiatër, etj., nuk parashikon nevojat për shërbime që kryhen njëkohësisht me të gjithë përfituesit, si dhe nuk përmbush standardet ndërkombëtare. Nga krahasimi i numrit të punonjësve në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit dhe numrin e tyre, vihet re mosrespektimi i normave orientuese, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi⁵.

⁵Vendimi nr.822, datë 6.12.2006, i Këshillit të Ministrave “Për standardet e përkujdesit shoqëror, personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale” dhe udhëzimi nr.1730, datë 27.9.2010 i ministrit përgjegjës për çështjet sociale “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, përpersonat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”

Gjatë intervistave të kryera me stafin profesionist të qendrës dhe nga vëzhgimet e kryera nga stafi i institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe për shkak të vështirësisë specifike të shërbimit, u konstatua konsum i stafit, lodhje, e cila ndikonte edhe në cilësinë e shërbimit dhe menaxhimin e situatave kritike të krijuara në momentin e inspektimit.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga organet e administratës shtetërore.

Në përfundim, ajo që do të sugjerohet në kuadër të parandalimit dhe marrjes së masave, për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve kundrejt fëmijëve me aftësi të kufizuara, ku sistemi i mbrojtjes sociale për identifikimin, vlerësimin, përfshirjen dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore të jetën funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit referuar parashtrimin të mësipërm, për çështjen në fjalë:

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për të kryer licensimin e qendrës sipas procedurave të liçensimit.
- Marrjen e masave në vazhdimësi, për të përfshirë në programe trajnimi për mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara stafin e institucionit, për etikën e sjelljes dhe të komunikimit, të pedagogjisë dhe të vlerësimit të nevojave të këtij target grupi, në bashkëpunim e bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.
- Marrjen e masave për rishikimin e strukturës organike të personelit, e cila duhet të hartohet në funksion të plotësimit të kërkesave e të standardeve të miratuara për PAK⁶, për qendrat rezidenciale dhe nevojave për shërbime të përfituesve të këtij institucioni.
- Rritjen e bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të punës me struktura të tjera, të cilat ofrojnë shërbime publike, për të mundësuar integrimin e përfituesve me diagnoza të lehta të shëndetit mendor në

⁶Vendimi nr.822, datë 6.12.2006, i Këshillit të Ministrave “Për standardet e përkujdesit shoqëror, personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale” dhe udhëzimi nr.1730, datë 27.9.2010 i ministrit përgjegjës për çështjet sociale “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale dhe ditore”

shkolla normale dhe kurse profesionale, me synim punësimin e tyre për të realizuar jetesë të pavaruar, duke krijuar raporte të vazhdueshme dhe të rifreskueshme me: shkollat, bizneset, profesionistë të lirë, etj.

- Marrjen e masave urgjente për të punësuar me kohë të plotë psikologë, duke respektuar standardet shërbimeve rezidenciale të PAK. Prania e psikologut do të lehtësonte: (a) punën e specialistëve për hartimin e plan-programeve individuale dhe plan-programeve në grup për përfituesit e këtyre qendrave; (b) ngarkesën psikologjike dhe nivelin e stresit gjatë punës, të cilat rrezikojnë punonjësit e stafit.
- Marrjen e masave për vazhdimësinë e shërbimit të supervizimit për punonjësit e këtyre qendrave, sidomos për specialistët, edukatorët dhe kujdestarët.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi e, në vijim të na informoni për qëndrimin Tuaj ndaj tij.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA